

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4241/1 datë 1.10.2025, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-4382/1 datë 15.10.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4407/6 datë 20.10.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 15-të mbajtur më 20.10.2025, miratoi si vijon:

Aktvendim për paralajmërim publik dhe për ndërprerjen e ritransmetimit të shërbimeve programore

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për prodhimtari, tregti, telekomunikacion dhe shërbime GLOBALSAT SHPKNJP Shkup, për shkak të ritransmetimit të shërbimeve programore që nuk janë të regjistruara në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) në përputhje me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LShMAAV).

Shkelja nga paragrafi (1) të kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-4382/1 datë 15.10.2025., që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET që Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për prodhimtari, tregti, telekomunikacion dhe shërbime GLOBALSAT SHPKNJP Shkup, menjëherë pas pranimit të këtij aktvendimi të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LShMAAV, përkatësisht të ndërpresë ritransmetimin e shërbimeve programore.

3. Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim përcaktimin nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi ka vepruar sipas aktvendimit për paralajmërim publik dhe për ndërprerjen me transmetim të shërbimeve programore.

4. Nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi nuk vepron sipas aktvendimit përkatësisht vazhdon të kryejë shkelje për të cilën është paralajmëruar publikisht, Agjencia në përputhje me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të LShMAAV, do të paraqesë kërkesë për iniciimin e procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente.

5. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë.

A r s y e t i m

Agjencia në përputhje me nenin 6 paragrafi (1) nënparagrafi 4 të LShMAAV, ndërmerr masa në përputhje me ligjin në rastet kur është kryer shkelje e dispozitave të LShMAAV ose dispozitave të miratuara në bazë të ligjit dhe kushteve dhe detyrimeve nga lejet.

Në bazë të nenit 28 të LShMAAV, Agjencia është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programve të radiodifuzerëve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të ligjit, lejeve, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet e tjera të miratuara nga Agjencia.

Në kuadër të kompetencave ligjore dhe në përputhje me nenin 27 dhe nenin 28 të LShMAAV, Agjencia me datë 14.10.2025., ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore të paketës programore të transmetuar nga operatori Shoqëria për prodhimtari, tregti, telekomunikacion dhe shërbime GLOBALSAT SHPKNJP Shkup, nga ku është konstatuar se operatori në fjalë që sipas notifikacionit të Agjencisë për Komunikime Elektronike mund të ushtron veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me datë 14.10.2025., për shfrytëzuesit e tij ka ritransmetuar shërbime

programore, që nuk përfshihen në çertifikatën për regjistrim të shërbimeve programore të Agjencisë, që është në kundërshtim me nenin 141 paragrafi (13) të LShMAAV. Konstatimet nga mbikëqyrja janë specifikuar në detaje në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-4382/1 datë 15.10.2025., që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LShMAAV dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-4382/1 datë 15.10.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4407/6 datë 20.10.2025., për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LShMAAV cekur në pikën 1. të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, miratoi aktvendim me të cilin ndaj subjektit në fjalë të ndërmerret masë paralajmërim publik dhe urdhërohet menjëherë pas pranimit të aktvendimit të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LShMAAV, në mënyrë që do të ndërpresë me ritransmetim të shërbimeve programore.

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti në fjalë ka vepruar sipas urdhërit, përkatësisht sipas paralajmërimit publik dhe ka ndërprerë me ritransmetim të shërbimeve programore.

Në përputhje me nenin 24 të LShMAAV, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik mund të ngrejë padi për inicim të kontesti administrativ para gjykatës kompetente. Padia për inicim të kontesti administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-4382/1 datë 15.10.2025.

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale,
Kryetari i Këshillit,
Mr. Sasho Stefanovski**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontesti administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontesti administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.